



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 26 dhjetor 2019, në mbledhjen e XX-të (njëzetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52 - ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 13:40.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Fitim Haziri, kurse ish anëtarja znj.Floretë Zejnullahu ka dhënë dorëheqje për shkak të zgjedhjes Deputete në Kuvendit e Republikës së Kosovës

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, Abaz Llugaliu, Drejtor i drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, dhe Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

### Rendi i ditës

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

**z.Faik Muçiqi,** drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të paraqes një kërkesë për zëvendësimin e një anëtarë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, kërkesë e cila është paraqitur edhe në KKSB-së, fjala është për përfaqësuesin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që deri tani ka qenë z.Naim Bajraktari i cili sigurisht ka marrë detyrë të re në FSK, kurse është kërkuar të zëvendësohet me z.Besfort Kruma, andaj meqë kjo çështje është kërkuar pas dërgimit të materialit të kësaj mbledhjeje të Kuvendit, kërkoj të përfshihet në rendin e ditës përkatësisht t'i rekomandohet Kuvendit për marrje të vendimit sepse edhe ashtu përcaktohet me dispozita ligjore që zëvendësimet e anëtarëve të KKSB-së të bëhen me vendim të Kuvendit.

**z.Rafet Llapashtica,** theksoi, jam në dijeni dhe i informuar nga shefi i Grupit të këshilltarëve të PDK-së që Komisioni Qendror Zgjedhur ka nxjerrë vendim me të cilin është zëvendësuar ish këshilltar i Kuvendit tashmë i dorëhequr z.Arbër Blaku, ndërsa është emëruar z.Pajtim Hodolli këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, vendim i cili i është dorëzuar edhe Kryesuesit të Kuvendit.

Andaj kërkesa është që në seancën e Kuvendit, para fillimit të punimeve i njëjti të jap betimin solemn sipas procedurave të parapara ligjore, si dhe këshilltari i cekur të njoftohet që të jetë prezent në seancë.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** lidhur me çështjen në fjalë, kanë kaluar gjitha procedurat ligjore, vendimi nga KQZ është nxjerrë sipas të cilit z.Pajtim Hodolli është emëruar këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës duke zëvendësuar ish këshilltarin z.Arbër Blaku i cili ka dhënë dorëheqje të përvokueshme nga pozita e këshilltarit të Kuvendit, andaj mund t'i rekomandojmë Kuvendit për procedim dhe dhënie të betimit nga z.Pajtim Hodolli.

Nëse nuk ka diçka tjetër rreth rendit të propozuar të ditës, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, duke përfshirë edhe pikat e shtesë të kërkuara nga dy parafolësit.

*Pas votimit, u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar, përfshirë edhe pikat shtesë, dhe atë;*

- ***Propozimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës për zëvendësimin e z.Naim Bajraktarit me z.Besfort Kruma, i nominuar për anëtarë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, Podujevë, (në pikën 3, kurse pika të ndryshme kalon në pikën 4)***

***Gjithashtu njëzëri u rekomandua që në fillim të mbledhjes së Kuvendit të jepet Betimi solemn nga z.Pajtim Hodolli i emëruar anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës (Vendimi i KQZ nr.prot.2001/2019 i datës 24.12.2019), pas dhënies së dorëheqjes së z.Arbër Blaku. (bashkëngjitur Vendimi i KQZ-së)***

## **1. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitin 2020**

**z.Abaz Llugaliu**, drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në bazë të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 13 thuhet, publikimi i listës së pronave të Komunës, paragrafi 1, thuhet, Komuna duhet të publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues, deri më 31 dhjetor të po atij viti.

Në mbledhjen e fundit të Ekzekutivit të Komunës, kemi marrë vendim që të publikohet një listë e tillë, edhe pse rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës është hartuar por ende nuk është nënshkruar respektivisht nuk ka hyrë në fuqi ende, mirëpo për një gjë të tillë na obligon edhe ligji, por që rregullorja specifikon procedurat e zbatimit të ligjit duke përfshirë edhe komisionet vlerësuese, numrin e tyre, mënyrën e formimit, e që për mendimin tim ajo draft rregullore do të jetë gogja e papërshtatshme.

Do të thotë që ne jemi të obliguar për këtë çështje, dhe Kryetari i Komunës ka përgatitur një propozim vendim të cilin jua kemi dërguar me material ngase sipas instruksioneve që kemi nga MAPL, nëse ne nuk e miratojmë dhe nëse nuk e publikojmë deri më 31 dhjetor të këtij viti listën e veçantë të pronave që planifikojmë t'i japim në shfrytëzim për vitin 2020, çdo vendim i kësaj natyre në vitin e ardhshëm do të na refuzohet. Fillimisht kemi përgatitur një listë e cila ju është përcjellë me materialin e kësaj mbledhjeje, mirëpo gjatë kësaj kohe, në bashkëpunim me zyrën ligjore kemi përgatitur një listë tjetër me të dhëna të njëjta por vetëm më e detajizuar dhe me forma tabelare, pra vetëm teknikisht është ripërgatitur, andaj si e tillë kërkojmë që ta shqyrtoni mundësinë që të zëvendësohet me atë të parën dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të vendimit në fjalë duke përfshirë edhe listën që sot ju paraqesim. Për çështje tjera në interes, mund të parashtroni pyetje dhe jam i gatshëm t'ju përgjigjem qoftë sot këtu në KPF qoftë në seancën e Kuvendit.

Po ashtu dëshiroj të theksoi se neni 13 i ligjit të cekur kërkon edhe publikimin e listës së përgjithshme të pronave komunale, unë kam parë te Komuna e Prishtinës e cila ka përgatitur një listë të tillë me një ankand publik, janë dhënë shumë mjete financiare për atë listë, por ne tani sa për informim tuajin matjet gjeodezike në sektorin privat me një Udhëzim Administrativ na janë liruar, andaj gjeodetët do ti kemi në dispozicion dhe shpresoj që përmes ortofotove dhe daljes në terren do të bëjmë çmos të përgatim një

listë të tillë në mënyrë që të mos shpenzojmë buxhet komunal, mirëpo vlen të theksohet se si listë zyrtare e të gjitha pronave komunale është kadastri si regjistër zyrtar në të cilën gjenden të gjitha pronat e që në 78 zona kadastrale janë rreth 2345 prona komunale, prej të cilave disa prej tyre janë utrina (siç e thotë populli) të cilat nuk i janë nevojitur askujt dhe kanë mbet si prona komunale dhe nuk janë edhe aq të leverdishme.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, sa kuptova prej drejtorit parafolës, fjala është për ndryshim të listës në aspektin teknik jo diçka tjetër.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështetë dhe njëkohësisht e rekomandojmë për mbledhjen e Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës. Urojmë që, meqë gjeodetët tani janë më të lirë, nga viti i ardhshëm ta kemi edhe ndonjë program ashtu siç e potencoj drejtori i DPKGJ, e që do të ishte i shumë mirëseardhur në mënyrë që përmes fotove që janë në MAP të kemi mundësi të shohim edhe gjendjen dhe t'i mundësohet investitorëve të ndryshëm të shohin dhe vlerësojnë ato prona dhe në mënyrë që të tërheqim investitor të mundshëm, andaj urojmë të realizohet çështja e cekur dhe atë me kapacitete të Komunës.

**z.Fitim Haziri,** theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e rekomandojmë këtë pikë që të diskutohet në Kuvend, si dhe kërkojmë që krahas kësaj liste të na sjellët edhe lista e përgjithshme me pronat komunale, në mënyrë që edhe ne si Kuvend ta kemi në dispozicion, me kërkesën që nëse është e mundur të klasifikohen këto prona të paluajtshme të Komunës dhe të jemi në dijeni se sa prej tyre janë të uzurpuara me që kemi informacione se ka prona të uzurpuara, andaj të dihen publikisht se kush janë ata uzurpator të pronave komunale.

**z.Rafet Llapashtica,** theksoi, natyrisht që edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo dëshiroj të shprehë një mendim duke parë disa komuna tjera por që në Komunën tonë deri tani është shkuar sipas mendimit të tyre që është parë e që nuk e di se a është menduar pozitivisht apo negativisht, mirëpo duke parë edhe shfrytëzimin e shesheve në komuna tjera, siç është Prishtina e cila organizon dhënie me qira të hapësirave publike me shtëpiza "verë n'dimër" dhe ka një qarkullim dhe thithje të të ardhurave komunale, por edhe Prizreni e ka bërë një gjë të tillë, prandaj jemi në dijeni se edhe Podujeva ka pak a shumë një shesh të tillë që është sheshi "Ali Ajeti" dhe sheshe tjetër i cili planifikohet të ndërtohet, andaj do të ishte mirë të mendohen mënyra që në sezone të ndryshme të jepen në shfrytëzim këto sheshe për qytetarë dhe bashkatdhetarë që vijnë nga diaspora por edhe një formë edhe Komuna të inkasoj të hyra vetanake nga ato qira. Jemi në dijeni se në mandatin e kaluar sheshi "Ali Ajeti" është dhënë me qira në sezonin e verës, e që mendoj se pronat dhe hapësirat është më mirë të ofrohen në shërbim të qytetarëve të Komunës por do të ishte edhe atraktive për qytetarët. Pra të mendohet ndonjë formë e organizimit për të dy sezonet, me theks dimrit për festat e dhjetorit edhe për faktin që shumë bashkatdhetarë vijnë në Kosovë dhe ne po shohim se si po mbushen sheshet e Prishtinës, prandaj edhe po e paraqes një kërkesë të tillë sepse mendoj se edhe ne mund të bëjmë diçka atraktive, diçka të ngjashme, të paktën për qytetarët e Komunës së Podujevës.

E mbështesë miratimin e listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, dhe uroj të ketë sa më shumë prona komunale të pashfrytëzuara të cilat jepen në shfrytëzim, andaj e mbështes t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, kurse pastaj komisioni për dhënie në shfrytëzim zhvillon dhe vlerëson procedurat përkatëse.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, konsideroj se diskutimet janë të favorshme për arsye se pronat me të cilat disponojmë ne si Komunë në mënyrë që aty ku është mundësia vërtetë të bëhen më atraktive dhe tërheqëse për investitor në ato hapësira/prona ku nuk bëhen dëme apo nuk ndodhin telashe në mënyrë që të përfitoj Komuna nga qiraja si dhe të bëhen investime të qëlluara për qytet dhe aty ku ka nevojë, besoj se është shumë në rregull kjo. Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që kjo pikë

e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe kërkesën e drejtorit të DPKGJ që lista e dërguar më parë të zëvendësohet me këtë që u prezantua.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që Lista e dërguar me materialin e mbledhjes, të zëvendësohet me Listën me format tabelare, me përmbajtjen e njëjtë të pronave të propozuara, (bashkëngjitur lista)*

## **2. Propozim Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019–2021**

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij plani, ndër të tjera theksoi, Komuna e Podujevës ka qenë një prej Komunave përfituese nga GIS për hartimin e planeve komunale të veprimit për eficiencë të energjisë, dokument të cilin para një kohe jo të largët na është dorëzuar një draft përfundimtarë i cili edhe ju është dërguar me material, andaj edhe e shfrytëzuam këtë thirrje të seancës që ta kemi në rendit ditë këtë propozim plan edhe pse paksa jemi vonuar sepse ashtu edhe siç shihet është për periudhën 2019-2021, por megjithatë është një dokument në të cilin kanë punuar bukur shumë ekspertët e GIS në bashkëpunim edhe me zyrtar të Komunës.

Nuk do të ndalem edhe shumë rreth planit sepse është bukur voluminoz dhe keni mund ta analizoni të gjithë, mirëpo ajo që vlen të theksohet është se, shembull, në dokument vërehet se figuron emri i zyrtarit z.Rasim Fejza si zyrtar për energji e që duhet të korrigjohet sepse në ndër kohë zyrtari i cekur ka një pozitë tjetër dhe janë bërë ndryshime brenda Komunës, andaj duhet të hiqet emri i z.Rasim Fejzës.

Po ashtu do të kërkoja nga ju që të jepni leje që në seancën e Kuvendit ku do të jenë edhe përfaqësuesit e GIS të marrin fjalën dhe të sqarojnë më në detaje këtë dokument, dhe natyrisht të paraqitni edhe vërejtjet, propozimet apo sugjerimet e juaja profesionale. E them këtë ngase siç shihet janë përfshirë shumë fusha dhe sektorë të rëndësishëm e që janë marrë të dhënat reale, andaj edhe mund ta quajmë një plan shumë të rëndësishëm dhe i cili do të na hyjë në punë shumë neve si Komunë, qoftë me vlerësimet e dhëna, qoftë me të dhënat dhe investimet që do të bëhen.

Pas planit të qëndrueshëm të eficiencës së energjisë që e kemi miratuar në vitin 2014-2020 me të cilin kemi qenë edhe në konferencën e kryetarëve të komunave në Gjenevë, si Komunë kemi ecur shumë në aspektin e energjisë, prandaj edhe kërkoja që ky plan sipas kësaj pike të rendit të ditës, edhe pse pak sa me vonesë, që të miratohet me ndonjë korrigjim apo plotësim ndryshim në mënyrë që ti hapim mundësi implementimit të tij pastaj.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, do të ishte mirë që në seancën e Kuvendit, brenda mundësive të jetë prezent një përfaqësues i GIS i cili do të mund të jep detaje dhe sqarime të nevojshme rreth këtij dokumenti sepse akterët kryesor të hartimit të këtij plani janë vetë ata. Plani si i tillë konsideroj se është mjaft i rëndësishëm për Komunën e Podujevës dhe vështirë se do të mund të jemi përfitues të ndonjë donacioni pa pasur të miratuar këtë dokument, si dhe krijohen kushte të mira për ndonjë investitor potencial në fushën e energjisë.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë këtë propozim plan, dokument i cili ka qenë edhe më herët në mënyrë edhe më të detajizuar. Urojmë që plani përkatës të futet në veprim. Është një fat i mirë që në ndërtesën e re të Komunës ndriçimi është ashtu siç e kërkojnë ata, për dallim prej ndërtesës së vjetër ku në momentin që do të hynin në atë objekt ekspertët e GIS do të shihnin se nuk kemi të bëjmë me eficiencë, mirëpo urojmë që ky dokument të mos manifestohet vetëm në ambientet e jashtme por të depërtoj edhe nëpër shkolla, nëpër spitale etj, dhe të shihet përbrenda se është një tendencë për të kursyer energjinë.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, nuk jam profesionist i kësaj lëmie por sa jam konsultuar me persona profesionistë të kësaj fushe të cilët kanë qenë më afër dhe kanë punuar në këtë dokument, më është thënë se është një plan gjithëpërfshirës, gjë të cilën në një mënyrë e sqaroj edhe drejtori i DSHPMSh ngase kanë kërkuar nga të gjitha sferat e jetës ku zhvillohen aktivitete, me theks ato publike që të përfshihen këto segmente.

**z.Fitim Haziri,** theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e rekomandon këtë pikë të rendit të ditës për seancën e Kuvendit të Komunës.

**z.Rafet Llapashtica,** theksoi, edhe ne në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e mbështesim që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për seancën e Kuvendit.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, urdhëroni a ka ndokush të interesuar që ta merr fjalën rreth këtij propozim plani i cili është mirë të ceket se ka marrë pëlqimin paraprak nga agjencia për efikasitet të energjisë, andaj si duket gjithçka është e qartë sa na përket neve si Komunë, mirëpo për çështje tjera profesionale sigurisht që në mbledhjen e Kuvendit do të sqarohemi nga ekspertët e GIS ngase zakonisht kur kemi të bëjmë me dokumente të tilla që hartohen nga akterë të ndryshëm jashtë Komunës, vijnë përfaqësuesit përkatës dhe japin sqarimet dhe përgjigjet më të hollësishme të nevojshme, mirëpo nëse Kuvendi e sheh jo të arsyeshme apo jo të rëndësishme që të vij përfaqësuesi i GIS ne i njoftojmë ata dhe nuk vijnë, por prezenca e tyre është shumë e rëndësishme sepse janë hartues kryesor të dokumentit dhe do të ishte transparente dhe gjithçka e qartë nëse informatat dhe sqarimet bëhen nga dora e parë dhe me qëllim që këshilltarët të jenë sa më shumë të informuar rreth këtij plani, përndryshe nëse ju nuk dëshironi unë i them të mos vie fare në seancë, e që ndoshta për ata do të ishte e mirëseardhur një gjë e tillë, andaj e hedh në votim, me korrigjimet që i ceku drejtori në fjalën hyrëse.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që në dokumentin në fjalë ku figuron "Rasim Fejza si Menaxher i Zyrës për Energji" të korrigjohet.*

### **3. Propozimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës për zëvendësimin e z.Naim Bajraktarit me z.Besfort Kruma, i nominuar për anëtarë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, Podujevë,**

*Nuk pati diskutime rreth kësaj pike ngase u konsiderua se të gjitha u sqaruar në hyrje të kësaj mbledhje, andaj edhe i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të zëvendësimit të përfaqësuesit të FSK-së në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.*

**Kryesuesi i Kuvendit** duke i njoftuar se furnizimi me Llaptop për këshilltarët e Kuvendit të cilët nuk i kanë marrë, është bërë dhe mund t'i marrin nesër pas seancës së Kuvendit, e konstatoi të mbyllur këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:10**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0005663/20  
Podujevë,  
26 dhjetor 2019**

**Kryesuesi i Komitetit  
Fatmir Gashi**